



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 694/Prot
13

Tiranë, më 2907.2016

VENDIM

Nr. 45, datë 2907.2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë, me aktivitetin e tij në formën ligjore person juridik,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit Nr.156, datë 20.06.2016, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 28.06.2016 e në vazhdim, grupi i inspektimit filloi hetimin administrativ, pranë kontrolluesit Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë, me objekt:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar dhe akteve nënligjore të miratuara nga Komisioneri nga kontrolluesi Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë, gjatë kryerjes së veprimtarisë të tij në fushën e arsimit.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrin Nr.156, datë 20.06.2016 të Komisionerit "Për kryerjen e hetimit administrativ" që do të ushtrohej pranë këtij kontrolluesi.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:

1. Kontrolluesi nuk ka kryer "Njoftimin" në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të nenit 21-22 të ligjit;
2. Kontrolluesi nuk ka rregullore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale por në rregulloret e brendshme për funksionimin e tij, ka të përfshira elementë dhe parime për mbrojtjen e të dhënave personale;
3. Kontrolluesi aplikon për disa punëmarrës (mësuesit e provimeve të maturës) të D.A.R. Vlorë "Deklaratën e Konfidencialitetit", por nuk e aplikon për të gjithë punëmarrësit, mësuesit, psikologët e D.A.R. dhe shkollave, të cilët aksesojnë të dhëna personale.

4. Konstatohet se dosjet personale të krijuara nga psikologët e gjimnazeve ruhen nga viti 2009, pasi koha e ruajtjes së të dhënave nuk është e përcaktuar në rregullore apo udhëzime specifike.
5. Konstatohet se D.A.R. Vlorë administron vetëm një adresë zyrtare të postës elektronike (e-Mail) dhe të gjithë punëmarrësit komunikojnë nëpërmjet postës elektronike personale ndërmjet njëri-tjetrit. Adresa e postës elektronike mundësohet nga M.A.S.

Faktet e sipërme përbëjnë shkelje administrative të neneve 21, 22, 27 dhe 28 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Në cilësinë e provës materiale, këtij procesverballi i bashkëngjiten këto dokumente:

- Rregullore e brendshme e funksionimit të D.A.R. Vlorë;
- Rregullore e etikës administrative të D.A.R. Vlorë;
- Deklaratë konfidencialiteti;
- Udhëzim Nr. 38 datë 07/10/2014 “për kriteret e mësuesit ndihmës ...”;
- Përshkrim pune për psikologun/punonjës social dhe përgjegjës të sektorit të IT-së;
- Printim nga portali www.darvlore.arsimi.gov.al i tabelës së të dhënave të mësuesve që kanë aplikuar në portalin “Mësues për Shqipërinë”;
- Praktikë e psikologut të shkollave në lidhje me Personat me Aftësi të Kufizuara.
- Dispozita normative për sistemin arsimor parauniversitar;

Siç dhe konstatohet në proces verbal, detyrimin për njoftim kontrolluesi nuk e kishte përmbyshuar, por në datë 19.07.2016 depozitoi pranë protokollit të Zyrës së Komisionerit formularin e njoftimit të plotësuar, konform kërkesave të neneve 21 dhe 22 të ligjit.

Kontrolluesi DAR Vlorë efektin e Deklaratës së Konfidencialitetit e kishte të kufizuar vetëm tek mësuesit mbikqyrës për provimet e maturës, të detyrueshëm formatin e gatshëm nga AKP, dhe jo për punëmarrësit e tjerë që aksesojnë të dhënat personale.

Lidhur me shërbimin psikosocial që ofrohet në shkollat 9-vjeçare dhe ato të mesme, psikologët/punonjës social, të cilët mbledhin e përpunojnë të dhëna sensitive të nxënësve vulnerabël, të nxënësve me probleme sociale, apo nxënësve problematikë në komunitet, nuk aplikojnë Deklaratë Konfidencialiteti.

Në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, por veçanërisht dhe në mbështetje të Udhëzimit Nr.12, të MAS-it datë 27.04.2015 “Për mbledhjen përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare dhe të nxënësve, si dhe përmbajtjen e dosjeve të tyre personale”, duhej të ishin marrë masat e duhura, ato më kryesoret që krijojnë një lloj sigurie dhe ecurie fillestare në mbrojtjen e të dhënave:

1-Formulari i Njoftimit, i cili nuk përmendet në këtë udhëzim, për faktin se ky formular konsiderohet të jetë kryer kohë para se të dilte akti nënligjor në fjalë.

2-Deklarata e Konfidencialitetit, (pika 14, gërma “b”), jo vetëm për një proces pune apo një strukturë, por në tërësi dhe vazhdimësi për gjithë aktivitetin e punëmarrësve të DAR Vlorë, që aksesojnë të dhëna personale.

3- Rregullorja e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale, (pika 19) sipas këtij udhëzimi.

Në përmbyllje të procesit administrativ, u hartua procesverbali, i cili u lexua në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit. Nga ana e tyre, përfaqësuesit e kontrolluesit u shprehën se do të përmbushin konstatimet e shprehura në proces verbal dhe do i paraqesin ato para seancës dëgjimore. Nga ana e kontrolluesit, nuk u paraqitën pretendime.

Duhet të theksojmë se, administrata e DAR Vlorë ishte në disponibilitet dhe seriozitet për bashkëpunim me grupin e inspektimit.

DAR Vlorë, po ashtu dhe të gjitha DAR-ct në vend, kanë vetëm një adresë zyrtare, për komunikimin elektronik gjatë ushtrimit të detyrës, dhe komunikimi zyrtar kryhet nëpërmjet adresave personale elektronike të punonjësve. Kjo është një shkelje flagrante, jo vetëm në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, por dhe për vetë sistemin arsimor në tërësi, pasi komunikimi administrativ zyrtar i kryer nëpërmjet postës elektronike personale të punonjësve, i heq të drejtat kontrolluesit mbi këtë komunikim.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, datë 30.04.2015, në datë 19.07.2016, përpara marrjes së vendimit përfundimtar, është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të kontrollit administrativ.

Në seancë dëgjimore, përfaqësuesi i kontrolluesit paraqiti rregulloren e D.A.R. Vlorë, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe një format standart të deklarates së konfidencialitetit. Gjithashtu përfaqësuesi i kontrolluesit, shprehur pretendimet e tij, duke i depozituar ato dhe të shkruara, duke bërë me dije si më poshtë:

1-Në datë 19.07.2016 është plotësuar nga D.A.R. Vlorë Formulari i Njoftimit, dhe faktohet në rregjistrin e Komisionerit.

2-Përfshirja e elementëve dhe parimeve në rregulloren e brendshme si dhe ligji nr.69/2012 “Për arsimin parauniversitar ka të sanksionuar mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale (neni 66 dhe 67).

3-Deklarata e Konfidencialitetit është aplikuar gjatë zhvillimit të Maturës Shtetërore, ndërkohë drejtorët e shkollave janë duke punuar për firmosjen e deklarates nga mësuesit e shkollave dhe kjo fazë do të përfundojë brenda muajit gusht.

4-Lidhur me dosjet e krijuara nga psikologët janë Dispozitat Normative 2013 të cilat përcaktojnë qartësisht rregullat e privatësisë dhe detyrimin e psikologut për ruajtjen e privatësisë.

5-Nuk kemi shkelje të nenit 27 dhe 28 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe janë marrë masat për sigurinë e tyre.

Zyra e Komisionerit, në lidhje me pretendimet e mësipërme vlerëson:

1-Mos plotësimi i Formularit të Njoftimit, është një shkelje serioze, pasi është procesi fillestar i mbrojtjes së të dhënave personale. Në sajë të përmbushjes të këtij detyrimi në kohë optimale nuk është çmuar nga Komisioneri, penalizimi i kontrolluesit D.A.R Vlorë sipas nenit 39, pika 1, gërma "d", i cili shprehet: *"..kontrolluesit që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë"*.

2- Mungesa e një rregulloreje të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale, do të thotë mungesë masash paraprake, me qëllim parandalimin e kundrvajtjes. Si e tillë, mungesa e rregullores është një shkelje parashikuar në ligj, konkretisht në nenin 27 të tij, i penalizueshëm sipas nenit 39, paragrafi 1, gërma "dh" i tij, i cili shprehet:

"..kontrolluesit që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zhatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit të përcaktuara në nenet 21, 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me gjobë, me nga 10 000 deri në 150 000 lekë".

Fakti që Drejtoria Arsimore Rajonale – Vlorë, ka reflektuar duke hartuar rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale, vlerësohet pozitivisht nga ana e Zyrës së Komisionerit. Një veprim i tillë flet për seriozitet dhe ndërgjegjësim të subjektit DAR-Vlorë, në zbatim të Udhëzimit të MAS-it Nr.12, datë 27.04.2015 *"Për mbledhjen përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare dhe të nxënësve, si dhe përmbajtjen e dosjeve të tyre personale"*.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit konkludon se, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39 pika 1, gërma "dh" të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar, janë thelbësore për vetë faktin e gamës së të dhënave sensitive dhe jo sensitive që ky kontrollues mbledh e përpunon. Si të tilla këto shkelje përbejnë *"kundërvajtje administrative"*, dhe sanksionohen me gjobë si më poshtë:

-dh) Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zhatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë."

Kontrolluesi, Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë, në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe, sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara konsistojnë në moszbatim të ligjit, akteve nënligjore e parimeve bazë të mbrojtjes së të dhënave personale. Ato lidhen me cënimin e sigurisë së të dhënave personale, kryesisht të subjekteve të të dhënave "nxënës" dhe "mësues".

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 27, 28, 39 paragrafi 1, gërma "dh", si dhe nenit 39, paragrafi 2 i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit, *Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë*, me gjobë në vlerën **50.000, (pesëdhjetë mijë) lekë**, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit, *Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë*, me gjobë në vlerën **50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.
3. Kontrolluesi, *Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë*, të realizojë për Zyrat Arsimore të cilat janë në varësi të tij, pajisjen e kontratave të punëmarrësve me Deklaratat e Konfidencialitetit sipas Vendimit Nr.6, datë 05.08.2013, të Komisionerit, si dhe të shtrijë efektet e rregullores së formalizuar për mbrojtjen e të dhënave personale pranë tyre, brenda një periudhe 3 mujore.
4. Kontrolluesi, *Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë*, në përputhje me Udhëzimin Nr.4, datë 16.03.2010 të Komisionerit "*Për marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit*", paragrafet, 3 dhe 4, si dhe në përputhje me kushtet në të cilat ushtron detyrat, të përcaktojnë afatet e mbajtjes të të dhënave personale sensitive, për nxënësit që mbartin informacion sensitiv.
5. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përbarimit.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot, më 29.07.2016

